

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.04.2023*

07.04.2023

Ora 11:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e zotit Ismail Jakupi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për anëtarë i këshillit bashkiak në zonën zgjedhore Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaç, Znj. P. Doçaj**
- **Parti politike:**
- **OJQ: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirmëngjesi, atëherë në seancën e sotme publike kemi vetëm një pikë në rendin e ditës, e cila lidhet me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin si subjekt zgjedhor të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Durrës, zotin Ismail Jakupi

Z. Y. Merkaç: Falemindert! Me vendimin nr. 147, datë 08.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka regjistruar Komitetin Nismëtar, i cili do të garantojë punën për paraqitjen e zotit Ismail Jakupi, si kandidat për anëtar të Këshillit të Bashkisë Durrës për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. I propozuar nga zgjedhësit. Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni, deklaratat e kandidatit për hapje llogarie, jetëshkrimi i kandidatit, lista e zgjedhësve për zonën zgjedhore, si dhe

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.04.2023*

formulari i vetëdeklarimit. Neni 70, pika 3 e Kodit Zgjedhor përcakton se komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar bashkie nëqoftëse mbështetet nga një numër i caktuar zgjedhësish që i përket 1 % të listës së zgjedhësve në zonën zgjedhore përkatëse. Referuar ekstraktit të listës së zgjedhësve, zona zgjedhore Bashkia Durrës ka 291.188 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) zgjedhës që i përket kufirit minimal prej 1 %, prej 2999 (dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëtë) zgjedhësish. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjes 810 (tetëqind e dhjetë) firma, kështu që nuk i plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3, neni 70, i Kodit Zgjedhor. Për këtë arsye i propozojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mosregjistrimin e zotit Ismail Jakupi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për anëtar të këshillit bashkiak, Bashkia Durrës për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ndonjë komunikim tjetër me kërkuesin nuk kemi patur. Mirë atëherë, vendosim:

1. Mospranimin e kërkesës për regjistrimin e zotit Ismail Jakupi si kandidat i propozuar nga zgjedhësit si kandidat për anëtar të Këshillit të Bashkisë Durrës për organet e qeverisjes vendore, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kas brenda tre ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Vendimi nr. 305

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

